



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
OSNOVNI SUD DJAKOVICA – BASIC COURT OF GJAKOVA

Bazuar në nenin 4 të Rregullores për procedurën e Rekrutimit të Praktikanteve në Gjykata, për praktikantë vullnetarë (pa pagesë), për kohë të caktuar, në kohëzgjatje prej 1 (një) viti,

Gjykata Themelore në Gjakovë

Shpall:

K O N K U R S

Nr. 06/2017

Titulli i vendit të punës: Praktikantë Vullnetarë

1. Gjykata Themelore në Gjakovë 20 (njëzet) pozita,
2. Gjykata Themelore në Gjakovë - Dega Rahovec 10 (dhjetë) pozita dhe
3. Gjykata Themelore në Gjakovë - Dega në Malishevë..... ..10 (dhjetë) pozita.

Pozita Nr.1

Titulli i pozitës: Praktikantë Vullnetarë

Vendi i punës: Gjykata Themelore në Gjakovë

Kohëzgjatja e emërimit: me afat të caktuar, në kohëzgjatje prej 1 (një) viti (pa pagesë)

Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë: Kryetari i Gjykatës

Pozita Nr.2

Titulli i pozitës: Praktikantë Vullnetarë

Vendi i punës: Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec

Kohëzgjatja e emërimit: me afat të caktuar, në kohëzgjatje prej 1 (një) viti (pa pagesë)

Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë: Gjyqtari Mbikëqyrës

Pozita Nr.3

Titulli i pozitës: Praktikantë Vullnetarë

Vendi i punës: Gjykata Themelore në Gjakovë - Dega në Malishevë

Kohëzgjatja e emërimit: me afat të caktuar, në kohëzgjatje prej 1 (një) viti (pa pagesë)

Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë: Gjyqtari Mbikëqyrës

Përshkrimi i detyrave të punës:

Detyrat e praktikantit: Ndhmon zyrën e administratës në organizimin dhe ruajtjen e lëndëve, si dhe menaxhimin e tyre në përgjithësi.

Detyrat kryesore:

- Vepron nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Kryetarit të Gjykatës / Gjyqtarit Mbikëqyrës dhe nën mbikëqyrjen e përgjithshme të Administratorit të Gjykatës / Ndhmës Administratorit;
- Ndhmon punën në zyrën e administratës lidhur me organizimin dhe ruajtjen e lëndëve si dhe në menaxhimin e tyre në përgjithësi;
- Ndhmon gjyqtarët në punët që kanë të bëjnë me futjen e lëndëve në dosje;
- Ndhmon në punën e zyrave të ndryshme në Gjykatë / Degë të Gjykatës duke përfshirë regjistrimin e shkresave të lëndës etj. dhe
- Kryen punë të tjera sipas nevojave të Gjykatës.

Kualifikimet:

- Diploma e Fakultetit Juridik, programi i studimeve 4 (katër) vjeçare, apo 240 kredi ECTS ose Master;
- Njohuri të procedurave gjyqësore;
- Aftësi për kryerjen e hulumtimeve gjyqësore (juridike);
- Njohuri të mjaftueshme ligjore dhe
- Aftësi të shkëlqyeshme në përpilimin me shkrim të drafteve juridike, duke përfshirë aftësinë për përpilimin e dokumenteve ligjore si dhe shkathtësi komunikimi në të folur.

VËREJTJE:

- Procedura e konkursit është e hapur për kandidatë të jashtëm.
- Procedura e rekrutimit zhvillohet sipas procedurave të parapara me Ligjin mbi Shërbimin Civil, Nr. 03/L- 149 dhe Rregulloren, Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Rregullores për Procedurën e Rekrutimit të Praktikantëve, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 2007/01.
- **Konkursi është publikuar me datë 22.12.2017 dhe mbyllet me datë 05.01.2018.**

Aplikacionet mund t'i merrni në Zyrën e Pranimit në Gjykatën Themelore në Gjakovë, Rr. "Bardhyl Çausi" nr. 148 dhe po ashtu, aplikacionet mund t'i shkarkoni në mënyrë elektronike në Web portalin e Gjykatës Themelore në Gjakovë: www.gjyqesori-rks.org.

[Shkarko Aplikacionin](#)

Aplikacionet e plotësuar mund t'i dorëzoni në Gjykatën Themelore në Gjakovë, Rr. "Bardhyl Çausi" nr.148 si dhe përmes postës - kodi postar 50000.

- Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, si specifikohet në Nenin 11, par.3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacioni e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

- Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë banorët e Kosovës prej moshës 18-64 vjeçare. Aplikacionet duhet të plotësohen qartë dhe lexueshëm. Në aplikacion duhet të shënohen të gjitha të dhënat e kërkuara. Duhet të përcaktohet saktësisht vendi dhe pozita për të cilën konkurren. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurrim, siç janë:
kopja e diplomës për shkollën e kryer, specializimet e ndryshme profesionale, certifikata që nuk jeni nën hetime, certifikata të tjera, dy rekomandime etj.

Nëse aplikacionit nuk ia bashkëngjiti dokumentet e duhura dhe nuk e plotësoni atë me shënime të sakta, ju vetë do ta humbni rastin për t'u futur në listën e ngushtë.

- Fotokopjet e dokumenteve të bashkëngjitura në aplikacion, kandidatët nuk kanë të drejtë t'i tërheqin prapa.
- Në rast të ndonjë pyetje apo paqartësie mund të kontaktoni në numrin e telefonit 0390/324- 130.